



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 143

Tiranë – E enjte, 6 gusht 2015

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 635, datë 15.7.2015	Për disa shtesa në vendimin nr. 1252, datë 10.9.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave të zhvillimit të tenderit publik për dhënien e së drejtës së përdorimit të frekuencave”, të ndryshuar..... 10739
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 647, datë 22.7.2015	Për miratimin e procedurave e të kriterëve për përfitimin e lehtësirave fiskale nga zhvilluesit dhe operatorët që operojnë në zonat e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik..... 10740
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 658, datë 29.7.2015	Për përcaktimin e procedurave për dhënien e licencave për prodhimin, çaktivizimin dhe riparimin e armëve..... 10745
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 664, datë 29.7.2015	Për shpërndarjen e fondit transitor për zbatimin e reformës së re administrativo – territoriale..... 10748
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 666, datë 29.7.2015	Për shpalljen e zonës së teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik në Spitalë, Durrës..... 10750
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 667, datë 29.7.2015	Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit..... 10754
Udhëzim i ministrit të Integritetit Europian nr. 1, datë 21.7.2015	Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 2, datë 14.5.2009, “Për funksionimin e komisionit të posaçëm për miratimin e materialeve të përkthyer të legjislacionit të BE-së në gjuhën shqipe”..... 10755
Udhëzim i ministrit të Financave nr. 22, datë 31.7.2015	Mbi përcaktimin e tarifës së shërbimit për qarkullimin e mjeteve të huaja të transportit të udhëtarëve të më shumë se 20 personave, përfshirë edhe drejtuesin e mjetit, si dhe mjeteve të transportit të mallrave me ngarkesë apo pa ngarkesë..... 10756
Urdhër i ministrit të Drejtësisë nr. 5205, datë 30.7.2015	Për delegim kompetence..... 10758

Urdhër i ministrit të Drejtësisë nr. 5206, datë 30.7.2015	Për delegim kompetence.....	10758
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 91, datë 28.7.2015	Për licencimin e shoqërisë “Energal” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.....	10758
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 92, datë 28.7.2015	Për licencimin e shoqërisë “Euron Energy” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.....	10759
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 93, datë 28.7.2015	Për licencimin e shoqërisë “HEC Kabash Porocan” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “Holta Kabash” dhe “Holta Porocan” me fuqi të instaluar përkatësisht 2.2 MW dhe 3.3 MW, (me fuqi totale 5.5 MW).....	10760
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 94, datë 28.7.2015	Për licencimin e shoqërisë “HEC Kabash Porocan” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.....	10761
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 95, datë 28.7.2015	Për licencimin e shoqërisë “Gama Energy” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.....	10762
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 96, datë 28.7.2015	Për licencimin e shoqërisë “Kisi-Bio-Energji” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.....	10762
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 97, datë 28.7.2015	Për rinovimin e licencës së shoqërisë “Ylliad” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 108, datë 22.12.2010.....	10763
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 98, datë 28.7.2015	Mbi fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Denas Power” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Denas” me fuqi të instaluar 14.5 MW.....	10764
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 99, datë 28.7.2015	Mbi fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Denas Power” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.....	10765
Kërkesë e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës nr. 3123/1, datë 29.7.2015	Për shpronësimet, për interes publik, të pasurive pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Levan-Tepelenë” (shtesa) për objekte, toka, kultura bujqësore dhe dru frutorë.....	10766

**VENDIM****Nr. 635, datë 15.7.2015****PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 1252, DATË 10.9.2008, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË ZHVILLIMIT TË TENDERIT PUBLIK PËR DHËNIEN E SË DREJTËS SË PËRDORIMIT TË FREKUENCAVE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pikat 1 e 3, e 69, të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në dokumentin “Rregullat e zhvillimit të tenderit publik për dhënie e së drejtës së përdorimit të frekuencave”, që i bashkëlidhet vendimit nr. 1252, datë 10.9.2008, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa:

a) Në fund të shkronjës “b”, të pikës 2.2, të kreut II, shtohen fjalët “... mënyrat e pagesës për autorizimin individual.”;

b) Në kreun III bëhen shtesat e mëposhtme:

i) Në fund të shkronjës “b”, të pikës 1.2, shtohen fjalët “... përfshirë dhe miratimin për mënyrat e pagesës ...”.

ii) Pas pikës 1.2 shtohet pika 1.2.1, me këtë përmbajtje:

“1.2.1 Aplikimi i pagesës me këste në një procedurë për dhënie e autorizimit individual miratohet nga ministri në momentin e dhënies së miratimit për procedurën sipas shkronjës “b”, të pikës 1.2, të këtij kreu, në rastet kur:

a) Aplikimi i pagesës me këste përshpejton investimet për ofrimin e shërbimeve në interes të publikut dhe sjell rritje të konkurrencës;

b) subjekte të interesuara në procesin e këshillimit kanë kërkuar dhe argumentuar aplikimin e saj në interes të shërbimeve ndaj publikut;

c) procedura për dhënie e autorizimit individual për përdorimin e frekuencave në një brez të caktuar frekuencash është zhvilluar më shumë se dy herë dhe ka ende spektër të lirë të papërdorur.”.

iii) Në fund të pikës 10.1 shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

“Në rastin e aplikimit të pagesave me këste, ofertuesi paraqet bashkë me ofertën dhe propozimin për kalendarin e pagesave. Kalendarin e pagesave nuk mund të jetë më shumë se një vit dhe pagesa e parë jo më pak se 20% e çmimit të ofertës. Aplikimi i pagesës me këste nuk e cenon të drejtën e çdo ofertuesi për paraqitjen e ofertës me një pagesë të vetme me marrjen e autorizimit.”.

iv) Në fund të pikës 11.1 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Në rastin e aplikimit të pagesave me këste, afati kohor i sigurimit të ofertës është të paktën 30 ditë më shumë se kalendarin e pagesave të propozuara sipas pikës 10.1, të këtij kreu.”.

v) Në fund të pikës 19.3 shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

“Në rastin e aplikimit të pagesave me këste, autorizimi individual lëshohet nga AKEP-i pas kryerjes së pagesës së parë. Kalendarin e pagesave përfshihet në kushtet e autorizimit individual.”.

c) Pas pikës 1.2, të kreut V, shtohet pika 1.3, me këtë përmbajtje:

“1.3 Kur aplikohet pagesa me këste, në dokumentin e tenderit përcaktohet koha për pagesën e parë. Ofertuesi do të paguajë brenda vitit, sipas kalendarit të propozuar në ofertë, pagesat e tjera respektive pas pagesës së parë plus interesin mbi këtë pagesë të llogaritur sipas kursit të bonove të thesarit në momentin e paraqitjes së ofertës. Pagesat do të derdhen prej ofertuesit që ka fituar të drejtën e përdorimit të frekuencës/brezit të tenderuar në buxhetin e shtetit. Moskryerja sipas afatit e pagesave me këste duke filluar nga pagesa e dytë çon në revokimin e autorizimit individual nga AKEP-i dhe konfiskimin e sigurimit të ofertës.”.

2. Ngarkohen ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike dhe Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

**VENDIM****Nr. 647, datë 22.7.2015****PËR MIRATIMIN E PROCEDURAVE E
TË KRITEREVE PËR PËRFITIMIN E
LEHTËSIRAVE FISKALE NGA
ZHVILLUESIT DHE OPERATORËT QË
OPEROJNË NË ZONAT E
TEKNOLOGJISË DHE ZHVILLIMIT
EKONOMIK**

Në zbatim të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 13, të ligjit nr. 9789, datë 19.7.2007, “Për krijimin dhe funksionimin e zonave ekonomike”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:**I. HYRJA E MALLRAVE SHQIPTARE NË
ZONËN E TEKNOLOGJISË DHE
ZHVILLIMIT EKONOMIK**

1. Furnizimi (hyrja) i mallrave shqiptare në zonën e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik trajtohet si furnizim me shkallë zero të TVSH-së, me kushtin që këto mallra të përdoren vetëm për qëllime të veprimtarisë ekonomike që zhvillohet në zonë dhe për të cilën janë destinuar, të furnizuara për zhvilluesin dhe për përdoruesit e vendosur në zonë.

2. Furnizimi (hyrja) i mallrave shqiptare në zonën e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik, të cilat nuk përdoren për qëllim të veprimtarisë ekonomike që zhvillohet në zonë, por janë për përdorim apo konsum përfundimtar, nuk trajtohet si furnizim me shkallë zero të TVSH-së. Për këto furnizime zbatohet shkalla tatimore e TVSH-së sipas përcaktimeve të ligjit nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”.

**II. DALJA E MALLRAVE NGA ZONA E
TEKNOLOGJISË DHE ZHVILLIMIT
EKONOMIK**

Mallrat, që dalin nga një zonë e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik, mund të jenë:

a) mallra që hidhen në qarkullim të lirë në pjesën tjetër të territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, pasi të kenë paguar të gjitha detyrimet e importit, përfshirë TVSH-në, sipas shkallës tatimore në fuqi;

b) eksporte ose rieksperte, me zero TVSH,

kur dalin jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë;

c) mallra që futen në njërën nga procedurat e tjera doganore ose lloje të tjera destinacioni doganor.

Mallrat apo produktet e transportuara nga një zonë e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik në një tjetër, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, konsiderohen dhe nuk janë subjekt i detyrimeve doganore dhe/ose tatimore.

**III. PËRJASHTIMI NGA TATIMI MBI
FITIMIN PËR ZHVILLUESIT E ZONËS SË
TEKNOLOGJISË DHE ZHVILLIMIT
EKONOMIK**

1. “Zhvilluesit e licencuar” të zonës së teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik, persona juridikë të licencuar, vendas ose të huaj, të cilët ndërtojnë, administrojnë dhe monitorojnë funksionimin e zonës së teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik, paguajnë për 5 vitet e para nga fillimi i veprimtarisë së tyre në zonë 50 % të normës së tatimit mbi fitimin të përcaktuar në ligjin specifik tatimor.

2. Lehtësia tatimore llogaritet me fillimin e veprimtarisë ekonomike nga zhvilluesi në zonë. Fillim i veprimtarisë ekonomike në zonë, për zhvilluesin e zonës, konsiderohet data e fillimit të punimeve, sipas përcaktimeve në marrëveshjen e institucionit përgjegjës me zhvilluesin.

3. Sipërmarrësit, të cilët ofrojnë dhe kryejnë shërbime ndërtimi, montimi, punë mbikëqyrëse etj. të kësaj natyre për “zhvilluesin e licencuar” në zonën e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik, nuk përfitojnë asnjë reduktim nga tatimi mbi fitimin në lidhje me veprimtarinë që kryejnë në zonën e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik.

4. Periudha e lehtësisë tatimore për zhvilluesit llogaritet nga data e fillimit të saj, deri 5 (pesë) vjet më pas. Pra, nëse lehtësia tatimore ka filluar në datën 1 korrik 2016, ajo do të përfundojë më 1 korrik 2021.

**IV. PËRJASHTIMI NGA TATIMI MBI
FITIMIN PËR PËRDORUESIT E ZONËS SË
TEKNOLOGJISË DHE ZHVILLIMIT
EKONOMIK**

1. Çdo person juridik, vendas ose i huaj, i cili është licencuar dhe ushtron veprimtari ekonomike brenda zonës së teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik, paguan, për 5 (pesë) vitet e para nga fillimi i veprimtarisë së tij në zonë, 50 %



të normës së tatimit mbi fitimin korporativ, të përcaktuar në ligjin specifik tatimor për tatimin mbi fitimin.

2. Lehtësia tatimore llogaritet nga data kur institucioni përgjegjës miraton fillimin e veprimtarisë ekonomike të përdoruesit në zonë dhe përfundon 5 (pesë) vjet më pas. Nëse lehtësia tatimore ka filluar në datën 1 tetor 2016, ajo do të përfundojë më 1 tetor 2021.

3. Sipërmarrësit, të cilët ofrojnë dhe kryejnë shërbime ndërtimi, montimi, punë mbikëqyrëse etj., të kësaj natyre për “përdoruesin” në zonën e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik, nuk përfitojnë asnjë reduktim nga tatimi mbi fitimin në lidhje me veprimtarinë që kryejnë në zonën e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik.

V. AMORTIZIMI I PËRSHPEJTUAR I AKTIVEVE KAPITALE

1. “Zhvilluesit të licencuar”, që investon në zonë, brenda 3 (tre) viteve nga data e fillimit të punimeve, sipas përcaktimeve në marrëveshjen e institucionit përgjegjës me zhvilluesin, i njihen si shpenzime të zbritshme të periudhës tatimore 20 % e shpenzimeve kapitale vjetore, (shembulli 1, në aneksin bashkëlidhur këtij vendimi), pavarësisht nga shumatat e amortizimit, sipas ligjit për tatimin mbi të ardhurat, për një periudhë 2-vjeçare.

2. “Përdoruesit”, që investon në zonë, brenda 3 (tre) viteve pasi institucioni përgjegjës miraton fillimin e veprimtarisë ekonomike të tij në zonë, i njihen si shpenzime të zbritshme të periudhës tatimore, për një periudhë 2-vjeçare, 20 % e shpenzimeve kapitale vjetore, pavarësisht nga shumatat e amortizimit, (shembulli 2, në aneksin bashkëlidhur këtij vendimi), sipas ligjit për tatimin mbi të ardhurat.

VI. PËRJASHTIMI NGA TAKSA VENDORE E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË PËR NDËRTIMET E REJA

Projektet e ndërtimit brenda zonës, të paraqitura nga “zhvilluesit e licencuar” të zonës së teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik, persona juridikë të licencuar, vendas ose të huaj, përjashtohen nga pagimi i taksës vendore të ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja, i parashikuar në nenin 27, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar. Organi kompetent që lëshon lejen e ndërtimit, nuk kërkon pagimin paraprak apo të

mëvonshëm të kësaj takse, por e pajis “zhvilluesin e licencuar” me lejen e ndërtimit.

VII. PËRJASHTIMI NGA TAKSA MBI PASURITË E PALUAJTSHME (NDËRTESA)

Ndërtimet e realizuara në zonën e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik, të realizuara, sipas projektit të “zhvilluesit”, përjashtohen nga taksa mbi pasuritë e paluajtshme (ndërtesa) të parashikuar në ligjin nr. 9632, datë 30.12.2006, “Për taksat vendore”, të ndryshuar, për një periudhë pesëvjeçare, duke filluar nga viti i parë kur lind detyrimi për pagimin e kësaj takse.

VIII. PËRJASHTIMI NGA TAKSA E KALIMIT TË SË DREJTËS SË PRONËSISË MBI PASURITË E PALUAJTSHME

1. “Zhvilluesit e licencuar” të zonës së teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik, persona juridikë të licencuar, vendas ose të huaj, janë të përjashtuar nga taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme, e parashikuar në nenin 28, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar.

2. “Përdoruesit” e zonës së teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik, persona juridikë, vendas ose të huaj, të cilët ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda zonës së teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik dhe kanë në pronësi të personit juridik pasuri të paluajtshme të vendosura në zonë, janë të përjashtuar nga taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme, e parashikuar në nenin 28, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar.

3. Pasuritë e paluajtshme të vendosura në zonën e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik, të cilat mund të jenë në pronësi të “personave fizikë” apo individëve, nuk përjashtohen nga tatimi mbi të ardhurat personale për kalimin e së drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme, të parashikuar në ligjin përkatës tatimor.

IX. NIVELI I NJOHJES SI TË ZBRITSHME TE SHPENZIMEVE PËR PAGA DHE KONTRIBUTE

1. Për vitin e parë fiskal të ushtrimit të aktivitetit, shpenzimet për paga dhe kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, që punëdhënësi paguan për punëmarrësit, njihen 150 % të vlerës. Kjo lehtësi jepet si për



“përdoruesit”, ashtu edhe për “zhvilluesit e licencuar”. Viti fiskal nënkupton periudhën brenda një viti kalendarik nga data kur fillon lehtësia tatimore, deri në datën 31 dhjetor të atij viti.

2. Për “zhvilluesin e licencuar” të zonës së teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik, person juridik i licencuar, vendas ose i huaj, merren në konsideratë shpenzimet e pagave dhe kontributet e punëdhënësit vetëm për të punësuarit në listëpagesat e tij. Kjo lehtësi tatimore nuk përfitohet nga sipërmarrësit e punimeve që operojnë mbi baza kontraktuale për llogari të “zhvilluesit të licencuar”. Në deklaratën vjetore të fitimit të tatueshëm, “zhvilluesi i licencuar”, që e përfiton këtë lehtësi, deklaron në rubrikën përkatëse koston reale të pagave dhe kontributeve dhe, më pas, shton si shpenzim të zbritshëm 50 % të tyre.

3. Në vitet në vijim pas vitit të parë të ushtrimit të veprimtarisë, shpenzimet shtesë për pagat, në raport me vitin paraardhës, për efekt të llogaritjes së fitimit të tatueshëm, njihen si shpenzime të njohura me 150 % të vlerës. Si bazë krahasimi, në këtë rast, merren shpenzimet mesatare mujore të pagave dhe kontributeve të vitit të parë, të cilat krahasohen me shpenzimet e pagave dhe kontributeve të çdo muaji të vitit të dytë. Nëse nga ky krahasim rezulton rritje e shpenzimeve në muajin përkatës të vitit pasardhës në raport me mesataren mujore të vitit të parë, do të njihet si shpenzim i zbritshëm edhe 50 % e kësaj vlere. I njëjti parim llogaritjeje zbatohet edhe për vitet pasardhëse, duke marrë parasysh shpenzimet mesatare mujore për paga dhe kontribute të vitit paraardhës.

4. Për “përdoruesin” e zonës së teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik, person juridik i licencuar, vendas ose i huaj, merren në konsideratë shpenzimet e pagave dhe kontributet e punëdhënësit vetëm për të punësuarit në listëpagesat e tij. Kjo lehtësi tatimore nuk përfitohet nga asnjë operator ekonomik i cili mund të ofrojë furnizime me shërbime në zonë, por nuk ka statusin e “përdoruesit”, të miratuar nga institucioni përgjegjës. Në deklaratën vjetore të fitimit të tatueshëm, “përdoruesi” që e përfiton këtë lehtësi deklaron, në rubrikën përkatëse, koston reale të pagave dhe kontributeve e, më pas, shton si shpenzim të zbritshëm 50 % të tyre.

5. Në vitet në vijim pas vitit të parë të ushtrimit të veprimtarisë, shpenzimet shtesë për pagat, në raport me vitin paraardhës, për efekt të llogaritjes së fitimit të tatueshëm, njihen si shpenzime të njohura me 150 % të vlerës. Si bazë krahasimi, në këtë rast, merren shpenzimet mesatare mujore të pagave dhe kontributeve të vitit të parë, të cilat krahasohen me shpenzimet e pagave dhe kontributeve të çdo muaji të vitit të dytë. Nëse nga ky krahasim rezulton rritje e shpenzimeve në muajin përkatës të vitit pasardhës, në raport me mesataren mujore të vitit të parë, do të njihet si shpenzim i zbritshëm edhe 50 % e kësaj vlere. I njëjti parim llogaritjeje zbatohet edhe për vitet pasardhëse, duke marrë parasysh shpenzimet mesatare mujore për paga dhe kontribute të vitit paraardhës.

X. SHPENZIMET E TRAJNIMIT TË PUNONJËSVE

1. Shpenzimet e trajnimit të punonjësve në zonat e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik, për efekt të llogaritjes së fitimit të tatueshëm, njihen si shpenzime të njohura të periudhës tatimore me dyfishin e vlerës, për një periudhë 10-vjeçare nga fillimi i veprimtarisë ekonomike. Kjo lehtësi jepet si për “përdoruesit”, ashtu edhe për “zhvilluesit e licencuar”. Viti fiskal nënkupton periudhën brenda një viti kalendarik nga data kur fillon lehtësia tatimore, deri në datën 31 dhjetor të atij viti.

2. Për “zhvilluesin e licencuar” të zonës së teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik, person juridik i licencuar, vendas ose i huaj, merren në konsideratë shpenzimet e trajnimit vetëm për të punësuarit në listëpagesat e tij. Kjo lehtësi tatimore nuk përfitohet nga sipërmarrësit e punimeve që operojnë mbi baza kontraktuale për llogari të “zhvilluesit e licencuar”. Në deklaratën vjetore të fitimit të tatueshëm, “zhvilluesi i licencuar” që e përfiton këtë lehtësi deklaron, në rubrikën përkatëse, koston reale të shpenzimeve të trajnimit dhe, më pas, shton si shpenzim të zbritshëm edhe 100 % të tyre.

3. Për “përdoruesin” e zonës së teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik, person juridik i licencuar, vendas ose i huaj, merren në konsideratë shpenzimet e trajnimit vetëm për të punësuarit në listëpagesat e tij. Kjo lehtësi tatimore nuk përfitohet nga asnjë operator ekonomik i cili mund të ofrojë furnizime me



shërbime në zonë, por nuk ka statusin e “përdoruesit”, të miratuar nga institucioni përgjegjës. Në deklaratën vjetore të fitimit të tatueshëm, “përdoruesi” që e përfiton këtë lehtësi deklaron, në rubrikën përkatëse, koston reale të shpenzimeve të trajnimit dhe, më pas, shton si shpenzim të zbritshëm edhe 100 % të tyre.

4. Shpenzimet e trajnimit duhet të jenë të justifikuar me kontratat përkatëse ndërmjet “zhvilluesit”, “përdoruesit” dhe ofruesit të shërbimit të trajnimit, qofshin këta persona juridikë vendas apo të huaj, persona fizikë apo individë të licencuar për trajnime

XI. SHPENZIMET PËR KËRKIM SHKENCOR DHE ZHVILLIM

1. Shpenzimet për kërkim shkencor dhe zhvillim njihen si shpenzime të zbritshme me dyfishin e vlerës, për një periudhë 10-vjeçare nga fillimi i veprimtarisë ekonomike.

2. Shpenzime për kërkim shkencor dhe zhvillim të kompanisë konsiderohen ato lloje shpenzimesh qëllimi i të cilave nuk është realizimi i shpejtë i të ardhurave dhe fitimit. Të tilla shpenzime përfshijnë kostot e kërkimit për projektimin, modelimin dhe dizenjimin e produkteve të reja apo kërkime të tjera të aplikuara teknologjike, të cilat mund të lehtësojnë zhvillimin dhe përmirësimin e ardhshëm të produkteve. Kjo lehtësi zbatohet për “përdoruesit” e zonës së teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik, të cilët prodhojnë produkte apo ofrojnë shërbime.

3. “Përdoruesit” e zonës së teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik duhet të evidentojnë në mënyrë të qartë shpenzimet për kërkim shkencor dhe zhvillim, duke i pasqyruar ato në raporte analitike të veçanta, të cilat janë objekt i kontrollit dhe verifikimit nga organi tatimor.

4. Në deklaratën analitike vjetore të fitimit të tatueshëm, “përdoruesi” që e përfiton këtë lehtësi deklaron, në rubrikën përkatëse të saj, koston reale të shpenzimeve për kërkim shkencor dhe zhvillim, dhe, më pas, në rubrikat shtesë shton si shpenzim të zbritshëm 100 % të tyre.

XII. TRANSFERIMI I VEPRIMTARIVE EKONOMIKE

1. Lehtësitë tatimore, të parashikuara në nenin 13, të ligjit nr. 9789, datë 19.7.2007, “Për krijimin

dhe funksionimin e zonave ekonomike”, nuk përfitohen, nëse konstatohet se “përdoruesi i miratuar”, që operon në zonën e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik, ka transferuar veprimtarinë ekzistuese të tij apo të personave të tjerë, e cila kryhej në pjesën tjetër të territorit shqiptar, në zonën e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik, me qëllim kryesor përfitimin e lehtësive të parashikuara në këtë ligj. Çdo transaksion që në thelb rezulton në transferimin e veprimtarisë ekonomike, sipas përcaktimit të mësipërm, e përjashton “përdoruesin” e zonës së teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik nga përfitimet fiskale.

2. Ky rregull përfshin transferimin tërësor apo të pjesshëm të veprimtarisë ekonomike, të tërësisë së aseteve apo të një pjese të tyre, kur kjo realizohet:

a) midis dy personave juridikë, nëse marrësi me statusin e “përdoruesit” të zonës së teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik, realizon vazhdimësinë e veprimtarisë së transferuar, pavarësisht se ky transferim është kryer kundrejt pagesës ose jo.

b) nga vetë personi juridik, që ka fituar statusin e “përdoruesit” të zonës së teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik, i cili transferon plotësisht apo pjesërisht veprimtarinë ekonomike apo asetet e tij nga pjesa e veprimtarisë ekonomike që ai ka zhvilluar apo zhvillon jashtë zonës ekonomike.

3. Transferimi nënkupton zhvendosjen e tërësisë së veprimtarisë ekonomike ose të një pjese autonome të një veprimtarie, e cila përfshin elemente të trupëzuara e, sipas rastit, të patrupëzuara, të cilat së bashku formojnë një veprimtari (sipërmarrje) apo një pjesë të një sipërmarrjeje, e cila, në gjendjen që transferohet në favor të “përdoruesit” të zonës së teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik, mund të vazhdojë të zhvillojë aktivitet ekonomik të pavarur, në kushte të ngjashme si përpara transferimit. Tërësia e aseteve që transferohen në kuadrin e një veprimtarie ekonomike, përbën fondin e investimit, i cili përfshin stokun, aktive të trupëzuara ose të patrupëzuara, patentat e ndryshme, kontratat e punësimit etj.

4. Konsiderohet si transferim i veprimtarisë ekonomike transferimi i tërësisë së aseteve apo i një pjese të tyre, që kryhen në kuadrin e një



operacioni bashkimi, përthithjeje, ndarjeje të personit juridik apo në kuadrin e ristrukturimit të një grupi.

XIII. MASAT QË NDËRMERREN NË RASTET E PËRFTIMIT ABUZIV TË LEHTËSIVE TATIMORE

1. Nëse produktet dhe mallrat nga zona e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik dalin për shitje në tregun e brendshëm me një çmim nën çmimin normal të tregut për produktin në fjalë ose produkte të ngjashme apo të zëvendësueshme në mënyrë direkte, dhe kur i shkaktohet dëm material industrisë vendase, ministria përgjegjëse për ekonominë aplikon një tarifë korrektimi të vlerës së munguar mbi produktin në fjalë.

2. Hetimi i çmimeve të aplikuara për shitjen e produkteve që dalin nga një zonë e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik e që hyjnë në pjesën tjetër të territorit doganor të Republikës së Shqipërisë bëhet nga ministria përgjegjëse për ekonominë, pas ankimit me shkrim të operatorëve ekonomikë që prodhojnë dhe/ose tregtojnë produktin në fjalë, ose produkte të ngjashme apo të zëvendësueshme në mënyrë direkte.

3. Në rastet kur nga hetimi i situatës rezulton se produktet dhe mallrat e dala nga zona e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik tregtohen me një çmim nën çmimin normal të tregut për produktin në fjalë ose produkte të ngjashme apo të zëvendësueshme në mënyrë direkte, përcaktohet një “tarifë korrektimi” (shitesë mbi çmimin e shitjes së atij produkti), e cila kërkohet të paguhet nga “përdoruesi” i cili i ka prodhuar ato në zonën e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik.

4. Për përcaktimin e çmimit të tregut të produkteve dhe mallrave që dalin nga zona e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik dhe tregtohen me një çmim nën çmimin normal të tregut për produktin në fjalë, merren në konsideratë:

a) të dhënat reale të çmimeve të shitjes të të njëjtit produkt të përdorur nga operatorë të tjerë;

b) çmimet e referencës që ndiqen apo publikohen nga organe shtetërore si dogana, tatimet, INSTAT-i etj.;

c) të dhëna të siguruara nga vetë investigimi që kanë bërë strukturat përkatëse të ministrisë përgjegjëse për ekonominë.

5. Administrata doganore dhe ajo tatimore, të

cilat autorizohen nga ligjet specifike të fushës së veprimtarisë së tyre për përdorimin e metodave alternative të vlerësimit të çmimeve, kostove dhe fitimeve, bashkëpunojnë dhe u përgjigjen kërkesave të ministrisë përgjegjëse për ekonominë në lidhje me të dhëna, evidenca, raporte, investigime dhe vlerësime çmimesh, mallrash apo produktesh, që bëjnë të mundur zbatimin e këtij neni për rastet e përfitimit abuziv të lehtësive tatimore.

6. Në rastin kur strukturat e autorizuar të ministrisë përgjegjëse për ekonominë vendosin të aplikojnë “tarifën e korrektuar të vlerës së munguar mbi produktin në fjalë”, e pasqyrojnë vendimin e marrë dhe masat përkatëse në aktin e konstatimit dhe procesverbalin përkatës. Bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, operatorët ekonomikë mund të apelojnë ndaj masave të ndërmarra dhe penaliteteve të vendosura nga organi i autorizuar. Ministri përgjegjës për ekonominë përcakton, me rregullore, njësinë përgjegjëse për hetimin e rasteve të tilla dhe detajon procedurat manuale të operimit të kësaj njësie.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

ANEKS PËR PIKAT 1 DHE 2, TË KREUT V “AMORTIZIMI I PËRSHEPJTUAR I AKTIVEVE KAPITALE”

Shembull 1/pika 1 e kreut V, të vendimit: Data e fillimit të punimeve sipas marrëveshjes ndërmjet institucionit përgjegjës dhe zhvilluesit të zonës është 5 janar 2016. Data e fillimit të investimit nga zhvilluesi është 1 korrik 2016. Në vitin 2016 shpenzimet kapitale në aktive afatgjata të zhvilluesit janë 50.000.000 lekë, në vitin 2017 ato janë 80.000.000 lekë dhe në vitin 2018 ato janë 100.000.000 lekë. Për efekt të zbatimit të kësaj lehtësie fiskale, në vitin 2016 do të njihen si shpenzime korrente $50.000.000 \times 20\% = 10.000.000$ lekë. Shumat shpenzimeve si më sipër do të jenë të zbritshme, për të gjithë investimin kapital të realizuar në atë vit. Njohja si shpenzime të zbritshme për një periudhë 2-vjeçare sa më sipër nënkupton dy vite të njëpasnjëshme.



Shembull 2/pika 2 e kreut V, të vendimit: Data e miratimit për fillimin e veprimtarisë ekonomike të përdoruesit në zonë, 1 korrik 2016. Data e fillimit të investimit nga përdoruesi, 1 shtator 2016. Në vitin 2016 shpenzimet kapitale të aktive afatgjata makineri, pajisje, instalime etj. Te përdoruesit janë 10.000.000 lekë, në vitin 2017 ato janë 50.000.000 lekë dhe në vitin 2018 ato janë 20.000.000 lekë. Për efekt të zbatimit të kësaj lehtësie, në vitin 2016 do të njihen si shpenzime korrente $10.000.000 \times 20\% = 1.000.000$ lekë dhe në vitin 2017 do të njihen si shpenzime korrente $50.000.000 \times 20\% = 10.000.000$ lekë. Njohja si shpenzime të zbritshme për një periudhë 2-vjeçare sa më sipër nënkupton dy vite të njëpasnjëshme.

VENDIM

Nr. 658, datë 29.7.2015

PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE PËR DHËNIEN E LICENCAVE PËR PRODHIMIN, ÇAKTIVIZIMIN DHE RIPARIMIN E ARMËVE

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të shkronjës “d”, të nenit 14, të ligjit nr. 74/2014, “Për armët”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. PROCEDURAT E LËSHIMIT TË LICENCËS PËR PRODHIMIN, ÇAKTIVI- ZIMIN DHE/OSE RIPARIMIN E ARMËVE

1. Licenca për prodhimin, çaktivizimin e riparimin e armëve të zjarrit, pjesëve përbërëse dhe municioneve të tyre u jepet personave fizikë ose juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, nga Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve (AKSHE), në Ministrinë e Mbrojtjes.

2. Në këtë vendim njësohen me armët e zjarrit edhe municionet dhe pjesët përbërëse të armës.

3. Miratimi ose refuzimi për lëshimin e licencës së prodhimit të armëve për kategoritë “A”, “B” dhe “C”, të përcaktuara në pikat 1, 2 dhe 3, të nenit 8, të ligjit nr. 74/2014, “Për armët”, bëhet me vendim të AKSHE-së, brenda 6 (gjashtë) muajve nga data e plotësimit të dokumentacionit të përcaktuar në pikën 14, të këtij vendimi.

4. Miratimi ose refuzimi për lëshimin e licencës për çaktivizimin dhe/ose riparimin e armëve të zjarrit për kategoritë “A”, “B” dhe “C” bëhet me vendim të AKSHE-së, brenda 3 (tre) muajve nga data e plotësimit të dokumentacionit të përcaktuar në pikën 14, të këtij vendimi.

5. Afati i vlefshmërisë së licencës së prodhimit të armëve është 10-vjeçar, me të drejtë rinovimi, ndërsa afati i vlefshmërisë së licencës për çaktivizimin dhe/ose riparimin e armëve është 7-vjeçar, me të drejtë rinovimi.

6. Procedura e rinovimit të licencës së prodhimit, çaktivizimit dhe/ose riparimit të armëve të zjarrit është e njëjtë me atë të dhënies së saj.

7. Pagesa për tarifën e licencimit për prodhimin e armëve të zjarrit është 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë.

8. Për licencën e prodhimit, për çdo tipologji artikulli që do të prodhohet, paguhet një tarifë shtesë prej 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekësh.

9. Tarifa për licencimin për çaktivizimin dhe/ose riparimin e armëve të zjarrit është 700 000 (shtatëqind mijë) lekë.

10. Tarifa është e njëjtë edhe për rinovimin e licencave të prodhimit ose çaktivizimit dhe/ose riparimit të armëve.

11. Tarifa për licencimin, prodhimin, çaktivizimin dhe/ose riparimin e armëve të zjarrit derdhet në buxhetin e shtetit.

12. Mandatpagesa e tarifës përkatëse paraqitet nga subjekti aplikues pas marrjes së vendimit nga Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve dhe para zbardhjes së licencës.

13. Licenca zbardhet 5 (pesë) ditë pune pas datës së shlyerjes së tarifës së licencimit.

14. Subjekti që kërkon të pajiset me licencë për prodhimin, çaktivizimin dhe/ose riparimin e armëve për kategoritë “A”, “B” dhe “C” paraqet pranë Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve kërkesën me shkrim, në formë autobiografike, me adresën e saktë dhe dokumentet origjinale ose fotokopjet e noterizuara, si më poshtë:

a) Ekstraktin e plotë historik, nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, me objekt aktiviteti në fushën për të cilën kërkohet pajisja me licencë;

b) Vërtetim nga prokuroria, që subjekti nuk është në procedim penal;



c) Dëshmi penaliteti për administratorin e shoqërisë;

ç) Përgjigjen me shkrim mbi besueshmërinë për administratorin e shoqërisë, lëshuar nga Policia e Shtetit;

d) Licencën për sigurinë dhe mbrojtjen e mjedisit për ambientet e prodhimit, çaktivizimit dhe/ose riparimit të armëve;

dh) Lejen e ndërtimit, shoqëruar me planimetrinë e objekteve për prodhimin, çaktivizimin dhe/ose riparimin e armëve dhe municioneve të tyre, ku të jenë të parashikuar repartet e prodhimit, magazinimit, laboratorit i analizave kimike e balistike, poligonet, si dhe çdo njësi tjetër e cila i nevojitet procesit të prodhimit;

e) Kontratën e punësimit me drejtuesin teknik, i cili duhet të jetë inxhinier mekanik, kimist ose specialist prodhimi me përvojë pune, të paktën, 3-vjeçare, në fushën e prodhimit të armëve;

ë) Skemën teknologjike të prodhimit, çaktivizimit dhe/ose riparimit, të miratuar nga drejtuesi teknik dhe nga administratori i shoqërisë;

f) Projektin e magazinave të lëndëve të para eksplozive, të miratuar nga Reparti i Inspektim-Shpëtim-Minierave, në përputhje me vendimin nr. 533, datë 8.7.2005, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores së teknikës së sigurimit për përdorimin civil të lëndëve plasëse në Republikën e Shqipërisë”;

g) Aktin teknik dhe projektin për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimi për mjediset ku do të prodhohen, magazinohen, çaktivizohen dhe/ose riparohen armët, ku të jenë përcaktuar sistemet e shuarjes së zjarrit, si brenda, ashtu edhe jashtë këtyre ambienteve;

gj) Planin e veprimit dhe dokumentacionin për kushtet e sigurisë në punë, trajnimin e punonjësve dhe stafit, të miratuar nga drejtuesi teknik dhe administratori i shoqërisë;

h) Kontratën për ruajtjen e ambienteve të prodhimit, magazinimit, çaktivizimit dhe/ose riparimit të armëve, me një shoqëri të pajisur me licencë të ruajtjes së sigurisë fizike, në të cilën të jetë parashikuar një plan i detajuar i masave të sigurisë, ku të përfshihen vendrojat, rrethimi, kamerat e sigurisë, si dhe çdo masë tjetër e marrë për sigurinë e objektit;

i) Dokumentacionin teknik mbi pajisjet testuese për provat balistike dhe për pajisjet laboratorike për provat kimike;

j) Dokumentacionin teknik për llojin, tipin, specifikimet teknike e standardet e ndjekura për armët dhe municionet që do të prodhohen, çaktivizohen dhe/ose riparohen.

k) Përpara zbardhjes së licencës subjekti aplikues duhet të paraqesë kontratën mbi sigurimin e përgjegjësisë publike të subjektit dhe sigurimin e jetës e të shëndetit të punonjësve nga aksidentet.

Dokumentacioni i përmendur më sipër duhet të jetë lëshuar nga organet kompetente, brenda 3 (tre) muajve të fundit nga data e aplikimit të subjektit.

15. Ndërmarrjet shtetërore ekzistuese që kryejnë veprimtari prodhimi, çaktivizimi dhe/ose riparimi të armëve, për t’u pajisur me licencë për prodhimin, çaktivizimin dhe/ose riparimin e armëve, paraqesin pranë Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve kërkesën me shkrim, në formë autobiografike, me adresën e saktë dhe dokumentet origjinale ose kopje të njësuara me origjinalin, si më poshtë:

a) Vendimin/urdhurin e emërimit të drejtorit të ndërmarrjes shtetërore;

b) Licencën për sigurinë dhe mbrojtjen e mjedisit për ambientet e prodhimit, çaktivizimit dhe/ose riparimit të armëve;

c) Planimetrinë e objekteve për prodhimin armëve dhe municioneve të tyre, ku të jenë të parashikuar repartet e prodhimit, magazinimit, laboratorit i analizave kimike dhe balistike, poligonet si dhe çdo njësi tjetër e cila i nevojitet procesit të prodhimit, çaktivizimit dhe/ose riparimit, të miratuar nga drejtori i ndërmarrjes;

ç) Urdhrin e emërimit të drejtuesit teknik/kryeinxhinierit të ndërmarrjes;

d) Skemën teknologjike të prodhimit, çaktivizimit dhe/ose riparimit, të miratuar nga drejtuesi teknik dhe nga drejtori i ndërmarrjes;

dh) Aktin teknik si dhe projektin për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimi për mjediset ku do të prodhohen, magazinohen, çaktivizohen dhe/ose riparohen armët, ku të jenë përcaktuar sistemet e shuarjes së zjarrit, si brenda, ashtu edhe jashtë këtyre ambienteve;

e) Planin e veprimit dhe dokumentacionin për kushtet e sigurisë në punë, trajnimin e



punonjësve dhe stafit, të miratuar nga drejtuesi teknik dhe drejtori i ndërmarrjes;

ë) Dokumentacionin teknik mbi pajisjet testuese për provat balistike, si dhe pajisjet laboratorike për provat kimike;

f) Dokumentacionin teknik mbi llojin, tipin, specifikimet teknike dhe standardet e ndjekura për armët dhe municionet që do të prodhohen, çaktivizohen dhe/ose riparohen.

16. Përfshihen nga detyrimi për pagesën e tarifës ndërmarrjet shtetërore të cilat aplikojnë për licencë për prodhimin, çaktivizimin dhe/ose riparimin e armëve, brenda 1 (një) viti nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

Në rast të privatizimit, dhënies me qira ose me koncesion të ndërmarrjeve shtetërore, subjekti që privatizon, merr me qira ose koncesion ndërmarrjen shtetërore duhet të aplikojë dhe të paraqesë të gjitha dokumentet e përcaktuara në pikën 14, të këtij vendimi, për t'u pajisur me licencë për prodhimin, çaktivizimin dhe/ose riparimin e armëve, si dhe të paguajë tarifën e licencimit, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

17. Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve, në përfundim të procesit të dorëzimit të dokumentacionit nga subjekti aplikues, ngre një komision, me specialistë të fushës, për vlerësimin në ambientet e prodhimit, çaktivizimit dhe/ose riparimit, të kushteve dhe kritereve të paraqitura në dokumentacionin e aplikimit.

18. Subjekti i pajisur me licencë për prodhimin, çaktivizimin dhe/ose riparimin e armëve, para fillimit të aktivitetit, depoziton një kopje të licencës në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

II. MBAJTJA E TË DHËNAVE DHE RAPORTIMI

1. Subjekti i pajisur me licencë për prodhimin, çaktivizimin dhe/ose riparimin e armëve duhet:

a) të mbajë të dhënat në regjistra elektronikë dhe në letër, mbi sasinë e prodhuar, çaktivizuar dhe/ose riparuar për çdo armë dhe municion të përfunduar, si dhe për pjesët përbërëse të tyre;

b) të mbajë të dhënat në regjistra elektronikë dhe në letër për çdo copë, sasi të shitur brenda apo jashtë vendit;

c) të mbajë të dhëna për çdo model eksperimental para prodhimit;

ç) të vulosë çdo pjesë përbërëse të armëve dhe municioneve të tyre, sipas përcaktimeve të vendimit nr. 348, datë 29.4.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat e hyrjes/daljes, vulosjes së armëve dhe regjistrimit të shtetasve shqiptarë e të huaj me armë të kategorive "B" dhe "C", në territorin e Republikës së Shqipërisë";

d) të përcaktojë procedurat dhe të kryejë testime periodike për cilësinë e produktit përfundimtar dhe pjesëve përbërëse;

dh) të raportojë, çdo muaj, pranë Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve, për sasinë e prodhuar, llojin, tipin, numrin e serisë.

2. Të dhënat e mësipërme duhet të mbahen nga subjekti për një afat minimal 10-vjeçar

III. SANKSIONET

1. Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve merr masën administrative "pezullim të licencës" në këto raste:

a) Kur, gjatë verifikimeve dhe kontrolleve të ushtruara, vëren shkelje të kushteve të përcaktuara në këtë vendim;

b) Kur, gjatë verifikimeve dhe kontrolleve të ushtruara, vëren se, pas pajisjes me licencë, subjekti i shmang ose i ndryshon kushtet dhe kriteret e përcaktuara për dhënien e licencës.

Në këto raste, subjektit i jepet një afat nga 1 (një) deri në 3 (tre) muaj për plotësimin e mangësive të konstatuara. Në përfundim të këtij afati, në rast se nuk janë plotësuar mangësitë, AKSHE-ja vendos për heqjen e licencës së prodhimit, çaktivizimit dhe/ose riparimit të armëve.

2. Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve vendos për heqjen e licencës në këto raste:

a) Kur, gjatë verifikimeve dhe kontrolleve të ushtruara, vëren përsëritjen e shkeljeve të përcaktuara në pikën 1, të këtij kreu;

b) Kur subjekti dënohet me vendim gjykate të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale, që lidhet me ushtrimin e veprimtarisë së importimit, eksportimit dhe prodhimit të armëve, apo që cenon jetën e shëndetin e njeriut;

c) Kur subjekti, gjatë importimit, eksportimit apo prodhimit të armëve, municioneve dhe pjesëve përbërëse të tyre, shkel rregullat teknike të prodhimit, transportimit, përdorimit, duke rrezikuar jetën e njerëzve, të kafshëve dhe mjedisin.



Subjekti, të cilit i hiqet licenca e prodhimit, çaktivizimit dhe/ose riparimit të armëve, nuk ka të drejtë aplikimi për pajisje me licencë për një periudhë 5-vjeçare.

IV. ANKIMIMI

1. Vendimet e Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve mund të ankimohen tek ministri i Mbrojtjes, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes dijeni.

2. Ministri i Mbrojtjes, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së ankimit, vendos për lënien në fuqi, ndryshimin ose shfuqizimin e vendimit të Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve.

3. Ndaj vendimit të ministrit të Mbrojtjes mund të bëhet ankim në rrugë gjyqësore, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes dijeni.

V. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve miraton, me akte të veçanta, procedurat për mënyrën e aplikimit, vlerësimit të kriterëve, kontrollin e kushteve të licencimit dhe formatet e licencave.

2. Ngarkohen Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve, Ministria e Mbrojtjes dhe ministria përgjegjëse për rendin dhe sigurinë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 664, datë 29.7.2015

PËR SHPËRNDARJEN E FONDIT TRANSITOR PËR ZBATIMIN E REFORMËS SË RE ADMINISTRATIVO - TERRITORIALE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15 e të aneksit 1, të ligjit nr. 160/2014, “Për miratimin e buxhetit të vitit 2015”, me propozimin e ministrit të Financave dhe të ministrit të Shtetit për Çështjet Vendore, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpërndarjen e fondit transitor në vlerën 1 857 683 000 (një miliard tetëqind e pesëdhjetë e shtatë milionë e gjashtëqind e tetëdhjetë e tre mijë) lekë, për zbatimin e reformës së re administrativo-territoriale, për 61 bashkitë, sipas tabelës 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ky fond të përballohet nga fondi për zbatimin e reformës së re administrativo-territoriale, miratuar për vitin 2015.

3. Ngarkohet Ministria e Financave dhe ministri i Shtetit për Çështjet Vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Tabela 1

Në mijë lekë

Nr.	Qarku	Njësitë e qeverisjes vendore	Bashki (B)	Vlera
1	Berat	Berat	B	29,484
2		Ura Vajgurore	B	19,260
3		Kuçovë	B	17,561
4		Skrapar	B	28,178
5		Poliçan	B	13,333
6	Dibër	Dibër	B	61,091
7		Bulqizë	B	36,089
8		Mat	B	26,517
9		Klos	B	12,593
10	Durrës	Durrës	B	68,427
11		Shijak	B	16,950



12		Krujë	B	50,476
13	Elbasan	Elbasan	B	67,751
14		Cërrik	B	19,994
15		Belsh	B	13,037
16		Peqin	B	21,593
17		Gramsh	B	30,556
18		Librazhd	B	35,785
19		Përrenjas	B	22,353
20	Fier	Fier	B	75,086
21		Patos	B	7,188
22		Roskovec	B	15,254
23		Lushnjë	B	48,143
24		Divjakë	B	40,929
25		Mallakastër	B	28,219
26	Gjirokastrë	Gjirokastrë	B	30,609
27		Libohovë	B	8,628
28		Tepelenë	B	12,027
29		Memaliaj	B	18,526
30		Përmet	B	19,630
31		Këlcyrë	B	10,291
32		Dropull	B	11,435
33	Korçë	Korçë	B	39,917
34		Maliq	B	46,173
35		Pustec	B	0
36		Kolonjë	B	26,641
37		Devoll	B	31,774
38		Pogradec	B	50,107
39	Kukës	Kukës	B	53,358
40		Has	B	17,332
41		Tropojë	B	39,056
42	Lezhë	Lezhë	B	90,356
43		Mirditë	B	36,639
44		Kurbini	B	36,485
45	Shkodër	Malësi e Madhe	B	40,638
46		Shkodër	B	66,571
47		Vau -Dejës	B	32,069
48		Pukë	B	19,803
49		Fushë-Arrëz	B	18,011
50	Tiranë	Tiranë	B	92,073
51		Kamëz	B	27,858
52		Vorë	B	10,878



53		Kavajë	B	25,846
54		Rrogozhinë	B	17,277
55	Vlorë	Vlorë	B	36,904
56		Selenicë	B	27,945
57		Himarë	B	13,390
58		Sarandë	B	6,325
59		Konispol	B	9,720
60		Finiq	B	24,773
61		Delvinë	B	2,771
TOTALI				1,857,683

VENDIM**Nr. 666, datë 29.7.2015**

**PËR SHPALLJEN E ZONËS SË
TEKNOLOGJISË DHE ZHVILLIMIT
EKONOMIK NË SPITALLË, DURRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4, të ligjit nr. 9789, datë 19.7.2007, “Për krijimin dhe funksionimin e zonave të teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen “Zonë e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik” të territorit, me sipërfaqe 501.9 (pesëqind e një pikë nëntë) ha, pjesë e zonës kadastrale nr. 8517, në Spitallë, Durrës, në përbërje të së cilës janë parcelat me numra pasurie, sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Shtrirja, kufijtë, pikat e hyrjes dhe të daljes së kësaj zone përcaktohen në hartën treguese, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Llojet e veprimtarive që do të zhvillohen në këtë zonë janë:

- prodhuese, industriale dhe agropërpunim;
- tregtare dhe magazinim mallrash;
- shërbime.

4. Periudha e funksionimit të zonës është 99 vjet.

5. Përzgjedhja e zhvilluesit të bëhet nëpërmjet procedurës konkurruese.

6. Si fazë e parë të përzgjidhet zhvilluesi për një sipërfaqe prej 212.8 (dyqind e dymbëdhjetë pikë tetë) ha, sipas hartës dhe numrave të pasurive, bashkëlidhur këtij vendimi.

7. Kriteret, në bazë të të cilave vlerësohen zhvilluesit, do të jenë:

- propozimi i projektit teknik;
- ndikimi mjedisor;
- ndikimi social;
- kohëzgjatja e punimeve;
- kapaciteti financiar i kompanisë dhe mundësia e financimit të projektit.

8. Vendimi nr. 72, datë 28.1.2015, i Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e zonës ekonomike, me statusin zonë e lirë në Spitallë, Durrës, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 391, datë 21.2.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen “Zonë ekonomike” në Spitallë, Durrës”, të ndryshuar”, dhe vendimi nr. 391, datë 21.2.2008, i Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen “Zonë ekonomike” në Spitallë, Durrës” shfuqizohen.

9. Ngarkohet Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Edi Rama**




**LISTA E PASURIVE QË DO
PËRFSHIHEN NË "ZONËN E
TEKNOLOGJISË DHE
ZHVILLIMIT EKONOMIK" FAZA
E PARË**

<i>Nr.</i>	<i>Zona kadastrale</i>	<i>Nr. pasurie</i>	<i>Lloji i pasurisë</i>
1	8,517	36	arë
2	8,517	37	arë
3	8,517	45	arë
4	8,517	46	arë
5	8,517	47	arë
6	8,517	48	arë
7	8,517	49	arë
8	8,517	50	arë
9	8,517	63	arë
10	8,517	64	arë
11	8,517	65	arë
12	8,517	66	arë
13	8,517	78	arë
14	8,517	79	arë
15	8,517	80	arë
16	8,517	81	arë

**LISTA E PASURIVE QË DO
PËRFSHIHEN NË "ZONËN E
TEKNOLOGJISË DHE ZHVILLIMIT
EKONOMIK"**

<i>Nr.</i>	<i>Zona kadastrale</i>	<i>Nr. pasurie</i>	<i>Lloji i pasurisë</i>
1	8,517	22	arë
2	8,517	23	arë
3	8,517	34	arë
4	8,517	35	arë
5	8,517	36	arë
6	8,517	37	arë
7	8,517	45	arë
8	8,517	46	arë
9	8,517	47	arë
10	8,517	48	arë
11	8,517	49	arë
12	8,517	50	arë
13	8,517	63	arë
14	8,517	64	arë
15	8,517	65	arë
16	8,517	66	arë
17	8,517	67	arë
18	8,517	76	arë
19	8,517	78	arë
20	8,517	79	arë
21	8,517	80	arë
22	8,517	81	arë
23	8,517	101	arë
24	8,517	102	arë
25	8,517	103	arë
26	8,517	104	arë
27	8,517	105	arë
28	8,517	147	vaskat



-  Kufiri i zonës
-  Rrugë 4 korsi
-  Porta hyrëse dhe dalëse të zonës

Sipërfaqja 501.9 ha

**VENDIM****Nr. 667, datë 29.7.2015****PËR ORGANIZIMIN DHE
FUNKSIONIMIN E DREJTORISË SË
PËRGJITHSHME TË AKREDITIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 8, të nenit 4, të ligjit nr. 116/2014, “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA) menaxhon sistemin e akreditimit të organeve të vlerësimit të konformitetit në sferën e detyrueshme dhe atë vullnetare në Republikën e Shqipërisë.

2. Selia e Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit është në Tiranë.

3. Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit nuk ka degë territoriale.

4. Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit operon në përputhje me standardet kombëtare, evropiane dhe ndërkombëtare, rregulloret, udhëzuesit dhe kërkesat për akreditim.

5. Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit siguron që i gjithë aktiviteti i saj akreditues të kryhet në interes publik dhe kërkon përfshirjen e balancuar dhe të ndershme të të gjitha palëve të interesuara në punën e saj.

6. DPA-ja ka detyrim plotësimin në mënyrë të vazhdueshme të kërkesave të neneve 9, 10 dhe 11, të ligjit nr. 116/2014, “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”. Në mënyrë të rregullt, brenda 10 (dhjetë) ditësh nga data e miratimit të drejtorit të Përgjithshëm, DPA-ja i dërgon ministrisë:

- dokumentin për politikën dhe objektivat e cilësisë;

- të dhëna për objektivat vjetorë;

- raportin vjetor në lidhje me ankesat dhe apelimet;

- raportin vjetor të Bordit të Akreditimit.

DPA-ja i dërgon ministrisë, në mënyrë të rregullt, brenda 10 (dhjetë) ditësh nga data e publikimit në faqen e vet zyrtare:

- raportin vjetor;

- raportimin vjetor në lidhje me shkallën e kënaqësisë së klientëve me procesin e akreditimit.

7. Plotësimi i kërkesave të neneve 9, 10 dhe 11, të ligjit nr. 116/2014, “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, vlerësohet edhe nëpërmjet auditimeve të kryera nga Drejtoria e Auditit në ministri.

8. DPA-ja informon ministrinë, brenda 5 (pesë) ditëve pune, për rezultatet e çdo vlerësimi të ndërsjellë të kryer nga Organizata Evropiane për Akreditim.

9. DPA-ja informon ministrinë çdo tre muaj për trajtimin e ankesave e të apelimëve në lidhje me akreditimin.

10. Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit bashkëpunon me ministrinë e linjës për përgatitjen e rregullave teknike për të siguruar respektimin e parimeve të akreditimit.

11. DPA-ja merr pjesë në veprimtarinë e organizatave evropiane dhe ndërkombëtare të akreditimit, si dhe në veprimtaritë e organizmave evropiane të organeve të miratuara.

12. DPA-ja bashkëpunon me institucionet publike dhe subjektet private, vendase ose të huaja, në mbështetje të veprimtarisë së saj.

13. DPA-ja informon organizatat evropiane dhe ndërkombëtare të akreditimit dhe anëtarët e saj për hartimin e legjislacionit të ri në fushën e akreditimit ose që kanë lidhje me akreditimin në Shqipëri.

14. DPA-ja, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së informacionit, njofton organet përgjegjëse të dhënies së miratimit për çdo dokument të përditësuar dhe të publikuar në nivel evropian, që ka lidhje me akreditimin.

15. Organet e vlerësimit të konformitetit, të regjistruara në Shqipëri dhe të akredituara nga organizma akreditues të huaj, informojnë DPA-në brenda muajit janar të çdo viti për statusin e tyre të akreditimit.

16. Për qëllime të miratimit, organi i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga një organizëm akreditues i huaj, i kërkon DPA-së pajisjen me dokument njohjeje për certifikatën e akreditimit dhe dokumentet shoqëruese të certifikatës.

17. Organi i vlerësimit të konformitetit që vepron në fushën vullnetare ose të detyruar, i interesuar për akreditim, aplikon drejtpërdrejt te



DPA-ja. Në procesin e vlerësimit për akreditim, aplikanti u përgjigjet kriterëve të akreditimit dhe në veçanti standardeve e udhëzuesve të nxjerrë nga organizmat ndërkombëtarë të akreditimit.

18. Organi i vlerësimit të konformitetit, që kërkon të akreditohet, për qëllime miratimi aplikon për akreditim, në bazë të kriterëve të përcaktuara në pikën 15, të këtij vendimi, si dhe në bazë të rregullave e kërkesave të veçanta teknike, që lidhen me dhënien e miratimit.

19. DPA-ja informon organet përgjegjëse të dhënies së miratimit në lidhje me kërkesën për akreditim dhe vendimet për statusin e akreditimit të organeve, të cilat kërkojnë të jenë apo janë të miratuara.

20. DPA-ja ka logon e saj të regjistruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Markave dhe Patentave. DPA-ja i jep të drejtën organeve të akredituara prej saj të përdorin simbolin e akreditimit. Simboli i akreditimit përbëhet nga logoja e DPA-së dhe numri i akreditimit. DPA-ja publikon rregullat e përdorimit të simbolit të akreditimit.

21. Akreditimi jepet për një afat kohor katërvjeçar.

22. Për organet e miratuara, mbikëqyrja e akreditimit nga DPA-ja bashkërenditet me atë të organeve përkatëse përgjegjëse, kur këto kryejnë vlerësimet periodike të statusit të miratimit. Nëse ka informacion se një organ i akredituar, i miratuar ose jo, nuk plotëson më kushtet e akreditimit, mbikëqyrja mund të kryhet në çdo kohë edhe pa lajmërim.

23. Në rastet kur DPA-ja konstaton një përdorim të gabuar të simbolit të miratimit, ajo lajmëron organin përgjegjës për miratimin.

24. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, përkatësisht, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

UDHËZIM

Nr. 1, datë 21.7.2015

PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 2, DATË 14.5.2009, “PËR FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT TË POSAÇËM PËR MIRATIMIN E MATERIALEVE TË PËRKTHYERA TË LEGJISLACIONIT TË BE-SË NË GJUHËN SHQIPE”

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit 9590, datë 27.7.2006, “Për ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit nëpërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane e shteteve të tyre anëtare”, pikave 5 dhe 9 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 119, datë 7.3.2007 “Për përcaktimin e procedurave të përkthimit të legjislacionit të BE-së në gjuhën shqipe dhe të përkthimit të legjislacionit shqiptar në një nga gjuhët e BE-së”, ministri i Integrimit Evropian

UDHËZON:

Në pikat 8 dhe 8.1 të udhëzimit nr. 2, datë 14.5.2009, “Për funksionimin e komisionit të posaçëm për miratimin e materialeve të përkthyer të legjislacionit të BE-së në gjuhën shqipe”, të bëhen këto ndryshime:

1. Pika 8 “Anëtarët e komisionit, të cilët janë ekspertë të jashtëm, do të shpërblehen për punën e kryer në vlerën 200 lekë për çdo faqe të shqyrtuar prej tyre”.

2. Pika 8.1 shfuqizohet.

3. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohet Drejtoria e Ligjeve të BE-së dhe Sektori i Buxhetit dhe Financës.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I INTEGRIMIT EUROPIAN
Klajda Gjoshë

**UDHËZIM****Nr. 22, datë 31.7.2015****MBI PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË SHËRBITIT PËR QARKULLIMIN E MJETEVE TË HUAJA TË TRANSPORTIT TË UDHËTARËVE TË MË SHUMË SE 20 PERSONAVE, PËRFSHIRË EDHE DREJTUESIN E MJETIT, SI DHE MJETEVE TË TRANSPORTIT TË MALLRAVE ME NGARKESE APO PA NGARKESE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës dhe të nenit 11 të ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, ministri i Financave

UDHËZON:

1. Niveli i tarifës së shërbimit për qarkullimin e automjeteve të huaja përcaktohet mbi bazë reciprociteti. Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës dërgon zyrtarisht në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave tarifën ose taksat që aplikohen nga shtetet e tjera për automjetet shqiptare për të njëjtin lloj shërbimi, brenda datës 20 dhjetor të çdo viti.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, në bazë të informacionit të dërguar nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, sipas pikës 1 të këtij udhëzimi, publikon dhe azhurnon këto tarifa në faqen e saj zyrtare në internet.

3. Tarifa e shërbimit për qarkullimin e automjeteve të huaja paguhet nga individ, drejtuesi i mjetit me targa të huaja.

4. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, nëpërmjet degëve të saj doganore, caktohet agjent për mbledhjen e kësaj tarife. Derdhja e tarifës bëhet mbi baza mujore në përputhje me procedurat e përcaktuara në këtë udhëzim, si dhe në udhëzimin nr. 26, datë 4.9.2008, “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar.

5. Drejtuesi i mjetit në momentin e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë me automjete me targë të huaj, pajiset nga dega doganore me një vërtetim hyrjeje sipas formularit nr. 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

6. Ky vërtetim mbahet në dy kopje, nga të cilat njëra i jepet personit që hyn në territorin e Republikës së Shqipërisë me automjet me targa të huaja, ndërsa kopja tjetër ruhet në degën doganore.

Ky vërtetim është i detyrueshëm të paraqitet në degën e doganës në pikën e kalimit kufitar në dalje, me qëllim që dega doganore të llogarisë dhe të arkëtojë tarifën e qarkullimit të automjetit me targë të huaj për ditët e qëndrimit në territorin e Republikës së Shqipërisë. Kjo pagesë bëhet me mandate arkëtimi, një kopje e të cilit i jepet personit, ndërsa kopja tjetër i bashkëlidhet vërtetimit që personi paraqet në dalje dhe ruhet në degën doganore.

7. Shumat e tarifave të arkëtuara në degët doganore regjistrohen në një regjistër të veçantë sipas formularit nr. 2 bashkëlidhur këtij udhëzimi, ku shënohet lloji i mjetit, ditët e qëndrimit, si dhe shuma e tarifës së paguar.

8. Degët doganore, në cilësinë e agjentit të mbledhjes së kësaj tarife, janë të detyruara:

a) të bëjnë deklaratë për çdo muaj për të ardhurat e mbledhura nga tarifa jo më vonë se 15 ditë pas përfundimit të muajit për të cilin bëhen deklaratimet;

b) të paguajnë për llogari të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, tarifën kombëtare të arkëtuar për atë muaj, në datën ose para datës së detyrueshme të deklaratës.

Për pagesën me vonesë të shumave të arkëtuara nga tarifa, për agjentin zbatohen sanksione sipas dispozitave të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Për shkeljet sipas përcaktimeve të nenit 117 të ligjit “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, për agjentin e tarifës zbatohen sanksionet e përcaktuara në këtë nen.

c) Deklarata bëhet në përputhje me modelin bashkëlidhur udhëzimit të ministrit të Financave nr. 26, datë 4.9.2008, “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar. Deklarata plotësohet dhe dorëzohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave vetëm në mënyrë elektronike, nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve www.tatime.gov.al. Deklarata konsiderohet e dorëzuar, në datën e dërgimit elektronik të deklaratës së plotësuar. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave duhet të dorëzojë deklaratën edhe në qoftë se për periudhën tatimore nuk ka për të paguar detyrime për tarifën.

Mosdeklarimi brenda datës 15 të muajit pasardhës, i çdo periudhe tatimore nga agjenti i



tarifës kombëtare, ndëshkohet me gjobë për mosdeklarim sipas dispozitave të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

9. Për shërbimin e kryer, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave nuk mban komision.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Shkëlqim Cani

Formulari nr. 1:

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Ministria e Financave
Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
Dega e Doganës

Nr. Serisë data : _____

Pjesa e Parë

Emri i shtetasit _____
Adresa: Qyteti, shteti _____
Numri i dokumentit të identifikimit _____
Tipi i mjetit _____
Targa e mjetit _____
Data e hyrjes _____
(me numra dhe me fjale)

Doganieri *Kryetari i Doganës*
(emer, mbiemer, firma) (emer, mbiemer, firma)

Pjesa e Dytë Data _____
Data e daljes _____
(me numra dhe me fjale)
Ditet e qëndrimit gjithsej _____
Në shifra dhe me fjalë _____
Shuma e tarifës së shërbimit _____
(në shifra dhe me fjalë)

Tarifa llogaritet në dalje të mjetit ose në momentin e zhdoganimit të mjetit kur mjeti pajiset me targa shqiptare.

Doganieri *Kryetari i Degës së Doganës*

(emër, mbiemër, firma) (emër, mbiemër, firma)

Pjesa e parë plotësohet nga dogana hyrëse dhe pritët në dy kopje njëra i jepet shtetasit, tjetra mbetet në doganë.

Pjesa e dytë plotësohet vetëm në kopjen e shtetasit në doganën që del mjeti ose ku bëhet zhdoganimi i mjetit në rastet kur mjeti pajiset me targa shqiptare dhe dorëzohet në këtë degë të doganës.

Formulari nr.2

REGJISTRI DITOR I TARIFËS SE QARKULLIMIT TË AUTOMJETEVE TË HUAJA

Nr	Lloji i mjeteve	Emri i zotëruesit të mjetit	Shteti nga vjen mjeti	Data e hyrjes së mjetit në doganën shqiptare	Masa e tarifës shërbimit	Shuma e taksave/tarifave të paguara
----	-----------------	-----------------------------	-----------------------	--	--------------------------	-------------------------------------

Dega e doganës

**URDHËR****Nr. 5205, datë 30.7.2015****PËR DELEGIM KOMPETENCE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9000, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, të nenit 7 pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, të nenit 27 të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Drejtësisë nga data 1.8.2015 deri në datën 20.8.2015, zëvendësministrit të Drejtësisë z. Ildir Peçi.

2. Ngarkohet zëvendësministri i Drejtësisë z. Ildir Peçi, për zbatimin e këtij urdhri.

3. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I DREJTËSISË
Nasip Naço

URDHËR**Nr. 5206, datë 30.7.2015****PËR DELEGIM KOMPETENCE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9000, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, të nenit 7 pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, të nenit 27 të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Drejtësisë nga data 21.8.2015 deri në datën 31.8.2015, zëvendësministrit të Drejtësisë z. Arben Isaraj.

2. Ngarkohet zëvendësministri i Drejtësisë z. Arben Isaraj, për zbatimin e këtij urdhri.

3. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I DREJTËSISË
Nasip Naço

VENDIM**Nr. 91, datë 28.7.2015****PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË
“ENERGAL” SHPK, NË AKTIVITETIN E
TREGTIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16, 37 germa “d”, dhe 110 të ligjit 43/2015, “Për sektorin e energjisë eklektike”, nenit 4 pika 1 germa “g”, neni 5 pika 2 dhe neneve 13 dhe 14 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionarëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.7.2015, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Energal” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit, Monitorimit të Tregut dhe të Licencuarve dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

1. Shoqëria “Energal” sh.p.k ka aplikuar për t’u pajisur me licencë për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike në datën 30.04.2015 në zbatim të ligjit nr. 9072, datë 23.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar. Bordi i Komisionerëve të ERE-s me vendimin nr. 63, datë 11.5.2015, miratoi fillimin e procedurave për licencimin në aktivitetin e tregtimit të shoqërisë “Energal” sh.p.k.

2. Njoftimi i kërkesës për licencim të këtij subjekti është kryer në zbatim të nenit 16 të ligjit nr. 9072 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

3. Në datën 15.5.2015 ka hyrë në fuqi ligji nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”.

4. Në ligjin nr. 43/2015, neni 110 pika 1, është parashikuar që ligji nr. 9072 datë 22.05.2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si dhe çdo dispozitë tjetër ligjore që bie në kundërshtim me ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, shfuqizohet.

5. Në ligjin nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, në zbatim të detyrimeve që burojnë nga vete ligji në nenin 39 dhe nenin 108 pika 3 të tij, në nenin 110 pika 2 të tij parashikohet se: Aktet nënligjore, që rregullojnë



veprimtaritë në sektorin e energjisë elektrike, të miratuara përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të zbatohen për aq sa nuk bien në kundërshtim me këtë ligj, deri në rishikimin e tyre dhe daljen e akteve të reja, në përputhje me kërkesat dhe afatet e vendosura në këtë ligj.

Për sa më sipër, si dhe duke qene se aplikimi i shoqërisë “Energal” sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1), është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 germat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”), është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3), është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Të dhënat specifike sipas tipit të licencës (neni 9, pika 4./10 germat “a”, “b” dhe “c”) janë plotësuar në mënyrë korrekte.

Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë “Energal” sh.p.k., ne aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike për një afat 26-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 92, datë 28.7.2015

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “EURON ENERGY” SHPK, NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16, 37 germa “d”, dhe 110 të ligjit 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, nenit 4 pika 1 germa “g”, neni 5 pika 2 dhe neneve 13 dhe 14 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të

Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28. 7.2015, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Euron Energy” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

1. Shoqëria “Euron Energy” sh.p.k. ka aplikuar për t’u pajisur me licencë për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike në datën 30.4.2015 në zbatim të ligjit nr. 9072, datë 23.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar. Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 54, datë 23.04.2015, miratoi fillimin e procedurave për licencimin ne aktivitetin e tregtimit të shoqërisë “Euron Energy” sh.p.k.

2. Njoftimi i kërkesës për licencim të këtij subjekti është kryer në zbatim të nenit 16 të ligjit nr. 9072 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

3. Në datën 15.5.2015 ka hyrë në fuqi ligji nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”.

4. Në ligjin nr. 43/2015, neni 110 pika 1, është parashikuar që ligji nr. 9072, datë 22.05.2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si dhe çdo dispozitë tjetër ligjore që bie në kundërshtim me ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, shfuqizohet.

5. Në ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, në zbatim të detyrimeve që burojnë nga vete ligji në nenin 39 dhe nenin 108 pika 3 të tij, në nenin 110 pika 2 të tij parashikohet se: Aktet nënligjore, që rregullojnë veprimtaritë në sektorin e energjisë elektrike, të miratuara përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të zbatohen për aq sa nuk bien në kundërshtim me këtë ligj, deri në rishikimin e tyre dhe daljen e akteve të reja, në përputhje me kërkesat dhe afatet e vendosura në këtë ligj.

Për sa më sipër, si dhe duke qene se aplikimi i shoqërisë “Euron Energy” sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1), është plotësuar në mënyrë korrekte.



- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 germat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”), është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3), është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Të dhënat specifike sipas tipit të licencës (neni 9, pika 4./10 germat “a”, “b” dhe “c”) janë plotësuar në mënyrë korrekte.

Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë “Euron Energy” sh.p.k., në aktivitetin e tregimit të energjisë elektrike për një afat 26-vjeçar.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 93, datë 28.7.2015

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “HEC KABASH POROCAN” SHPK NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGISË ELEKTRIKE NGA HEC – ET “HOLTA KABASH” DHE “HOLTA POROCAN” ME FUQI TË INSTALUAR PËRKATËSISHT 2.2 MË DHE 3.3 MW, (ME FUQI TOTALE 5.5 MW)

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37 germa “a” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”; neneve 4, pika 1, germa “a”, 5 pika 1, germa “a”, 13 dhe 14 pika 1 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 28.7.2015, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “HEC Kabash Porocan” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike,

Faqe | 10760

konstatoi se:

1. Shoqëria “HEC Kabash – Porocan” sh.p.k. ka aplikuar për t’u pajisur me licencë për prodhimin e energjisë elektrike në datën 13.5.2015 në zbatim të ligjit nr. 9072, datë 23.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar. Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 76, datë 8.6.2015, miratoi fillimin e procedurave për prodhimin e energjisë të shoqërisë “HEC Kabash – Porocan” sh.p.k.

2. Njoftimi i kërkesës për licencim të këtij subjekti është kryer në zbatim të nenit 16 të ligjit nr. 9072, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

3. Në datën 15.5.2015 ka hyrë në fuqi ligji nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”.

4. Në ligjin nr. 43/2015, neni 110 pika 1, është parashikuar që ligji nr. 9072 datë 22.5.2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si dhe çdo dispozitë tjetër ligjore që bie në kundërshtim me ligjin nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, shfuqizohet.

